

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 7967 Prot.

Tiranë, më 20.12 2019

URDHËR

Nr. 611, datë 20.12 . 2019

PËR
FORCIMIN E KONTROLLIT TË SHTETASVE SHQIPTARË QË KALOJNË KUFIRIN
SHTETËROR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 5, të neneve 6, 13, 14 dhe 15, të ligjit nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar",

URDHËROJ:

1. Të forcohet kontrolli i shtetasve shqiptarë në dalje të kufirit shtetëror, që nuk plotësojnë kushtet e udhëtimit për hyrjen dhe qëndrimin në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonës Schengen, duke kryer verifikime dhe intervistime të detajuara për:
 - a) adresën e saktë të akomodimit në vendin e destinacionit ku do të shkojë;
 - b) ftesën e pritësit në vendin e destinacionit (që përmban të dhënat, kontaktet e pritësit);
 - c) biletën apo rezervimin për kthimin;
 - d) mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve për kohën e qëndrimit.
2. Në funksion të kontrollit dhe verifikimit kufitar, ndaj të gjithë shtetasve shqiptarë që kanë shënime, njoftime dhe informacione të autoriteteve ligjzbatuese, të shfaqura automatikisht ose me kërkim në sistemet elektronike, si dhe ato që vijnë në formë shkresore, është e nevojshme kryerja e një kontrolli dhe verifikimi kufitar të vijës së dytë minimal ose tërësor, sipas rasti, apo të kalohet në verifikim të hollësishtëm.
3. Të gjithë shtetasit shqiptarë të kategorisë "Inad", gjatë dy viteve të fundit, nga data e paraqitjes në Pikat e Kalimit Kufitar, për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën "Schengen", me arsyetimin "Për informacione në SIS", "Refuzim azili", dhe "Rrezik për

- sigurinë publike” dhe të gjithë shtetasit shqiptarë të kategorisë “Deportiv” gjatë tre viteve të fundit, nga data e paraqitjes në PKK, për shkak të çdo lloj arsye dhe janë të regjistruar në sistemin TIMS si të tillë, të mos lejohen të kalojnë kufirin shtetëror deri në paraqitjen e një dokumenti shkresor, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, që provon se nuk kanë ndalim hyrje, urdhër largimi ose dëbimi në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonën Schengen.
4. Të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë shënime apo njoftime në sistemin TIMS dhe informacione të autoriteteve ligjzbatuese, për vepra penale (të trafikimit, falsifikimit të dokumenteve, kontrabandës, etj.), të kalojnë për kontroll në vijën e dytë për dokumentet e udhëtimit, sendet dhe mjetet e transportit.
 5. Kur shtetasit paraqesin dokumente justifikuese, administrative apo gjyqësore, që provojnë se nuk ka pengesë për të udhëtuar në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonën Schengen, roja kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar të bëjë shënimet përkatëse në sistemin TIMS tek rubrika “Shënime”. Një kopje origjinale ose fotokopje e njëzuar me origjinalin e dokumentit justifikues, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, administrohet në Pikën e Kalimit Kufitar për një periudhë 2 vjeçare.
 6. Në të gjitha rastet e kthimeve të shtetasve shqiptarë si “Inad” dhe “Deportiv”, bazuar në dokumentet që posedojnë apo të intervistimit në rastet kur ai mungon, të bëhen shënime në TIMS, në rubrikën “Shënime” për arsyen e kthimit dhe afatin e ndalimit të hyrjes në vendet e Schengenit/BE-së duke zbatuar procedurat e punës për regjistrimin në sistemin TIMS.
 7. Në rastet që shtetasit shqiptarë nuk lejohen të dalin nga kufiri shtetëror, deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë urdhër, të zbatohet procedura standarde për regjistrimin në sistemin TIMS në modulën “Shënime”, duke reflektuar arsyet e moslejimit të përkohshëm të daljes, në aktin përkatës, sipas përcaktimeve të mëposhtme:
 - a) nuk ka dokumentacionin e duhur që justifikon qëllimin e udhëtimit dhe kushtet e qëndrimit;
 - b) ka qëndruar më shumë se 90 ditë në 180 ditët e fundit, në territorin e zonës Schengen;
 - c) nuk ka mjete të mjaftueshme jetese (financiare) për periudhën, kohën dhe mënyrën e qëndrimit, ose mjete financiare për kthimin në Shqipëri;
 - d) është person për të cilin rezulton njoftim/informacion në sistem.
 8. Të forcohet kontrolli në kufi, ndaj operatorëve turistikë (linja autobuzësh, zyra turistike, etj.), grupe familjarësh, me qëllim parandalimin e rasteve të abuzimit me të drejtën e lëvizjes së lirë dhe goditjen e organizatorëve të këtyre udhëtimeve me destinacion vendet e Bashkimit Evropian.
 9. Të bashkëpunohet me Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Komisaritet për shkëmbimin e informacionit, nëse ka persona që kanë tendencën e organizimit dhe lëvizjes së shtetasve shqiptarë drejt vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Schengen, me qëllim për të kërkuar azil në këto vende.

7. Të bashkëpunohet me oficerët e kontaktit të Ministrisë së Brendshme, në vendet e BE-së për verifikimin, shkëmbimin e informacionit, si dhe trajtimin e rasteve të kalimit të kufirit nga shtetasit shqiptarë të dyshuar për të kërkuar azil në vendet e BE-së.
11. Të bashkëpunohet me policinë e vendeve fqinje dhe më gjerë për shkëmbimin e informacionit dhe trajtimin e rasteve të kalimit të kufirit nëpërmjet vlerësimit të analizës së riskut (*Modus operandi*, rrugët e lëvizjes, destinacionin etj.).
12. Për kontrollin dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit.
13. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.
14. Urdhri nr. 805, datë 01.08.2017, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

MINISTRI

SANDËR BLESHAJ

